

**STATUTI I FONDACIONIT**  
**“QENDRA RINORE MOTRAT VENERINI - GJADËR LEZHË ”**

Fondacioni “**QENDRA RINORE MOTRAT VENERINI - GJADËR LEZHË** ” është një organizatë jofitimprurëse, joqeveritare dhe jopolitike .

Ky fondacion themelohet në bazë të K. Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit Nr 8788 date 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse ” (i ndryshuar) . Ky themelohet dhe vepron mbi parimet e krishtera dhe i përkushtohet qëllimeve të shprehura në mënyrë të hollësishme në Nenin 3.

Anëtarët e fondacionit vendosin ta miratojnë këtë Statut me qëllimin që të vendosin rregullimin e çështjeve të organizimit, të funksionimit dhe të veprimtarisë së “**QENDRA RINORE MOTRAT VENERINI - GJADËR LEZHË** ”, në funksion të realizimit të qëllimit, misionit dhe objektivave brenda fushës se veprimtarisë të saj me ndërgjegje të lartë qytetare dhe profesionalizëm.

**NENI 1**  
**EMRI I FONDACIONIT**

Organizata do të quhet Fondacioni “**QENDRA RINORE MOTRAT VENERINI - GJADËR LEZHË** ” Shoqata do të ketë vulën dhe siglën e saj.

Fondacioni ka siglën e saj ku shkruhet “**QENDRA RINORE VENERINI SHTEPIA ROZALBA GJADËR - LEZHË**”.

**NENI 2**  
**ANËTARËT E FONDACIONIT**

Anëtarët e fondacionit “**QENDRA RINORE MOTRAT VENERINI - GJADËR LEZHË**” janë :

- 1- Arta Suli me atësi Mark dhe amësi Mrike, e datëlindjes 17.3.1975 , me Nr. Personal H55317052G.
- 2- Alma Zogu me atësi Jak dhe amësi Regjina, e datëlindjes 29.12.1984 , me Nr. Personal I46229022V.
- 3- Mirela Qafa me atësi Zef dhe amësi Marte, e datëlindjes 13.4.1979 , me Nr. Personal H95413042J.
- 4- Mariglana Gjoni me atësi Gjon dhe amësi Angje, e datëlindjes 03.6.1979 , me Nr. Personal H95603025V.
- 5- Kristianë Marku me atësi Muce dhe amësi Violeta, e datëlindjes 30.05.1994 , me Nr. Personal J45530104T.
- 6- Enrichetta Giovannini me atësi Amadeo dhe amësi Lina, e datëlindjes 19.3.1957 , me Nr. Personal H55317052G.

### **NENI 3 QËLLIMI**

Qëllimi i fondacionit **“QENDRA RINORE MOTRAT VENERINI - GJADËR LEZHË”** në pikat kryesore është :

- Fondacioni zhvillon aktivitetet e tija në fushën sociale dhe përkujdesjeje, edukative, formuese, në mbrojtjen e të drejtave, në mbrojtjen e ambientit, në fushën e anti trafikimit dhe të promovimit të njeriut.

-Fondacioni i realizon këto aktivitete nëpërmjet projekteve të ndryshme dhe vullnetariatit. Fondacioni promovon zhvillimin e vullnetariatit si formë zhvillimi qytetar dhe shoqëror. Fondacioni **“QENDRA RINORE MOTRAT VENERINI - GJADËR LEZHË”** për këtë qëllim përdor dhe bazohet mbi vullnetariatit për zhvillimin e aktiviteteve të veta institucionale.

Fondacioni nuk e zhvillon aktivitetin e saj për qëllime fitimi, por vetëm në angazhim të së mirës dhe interesit të shoqërisë.

Qëllimet institucionale që fondacioni propozon te ndjekë janë:

- Të promovojë dhe të zhvillojë aktivitete që kanë në fokus mbrojtjen e minoreneve, të viktimave të trafikimit, gra dhe viktimat të dhunës, të rinjve, familjeve dhe të gjithë personave që gjenden ne situata nevojë, në vështirësi sociale, juridike dhe ekonomike.

- Të promovojë dhe të zhvillojë aktivitete sociale, formuese dhe profesionale ku këto të fundit kanë si qëllim shoqërimin e përfituesve drejt integritit të plotë në jetë.

- Fondacioni mund të zhvillojë dhe të promovojë aktivitete në favor të të gjithë përfituesve të lartpërmendur në bashkëpunim ose bashkëfinancim me shoqata, organizata, fundacione fetare ose jo ,brenda dhe jashtë Shqipërisë në respekt të çdo rregulli të parashikuar në statut apo në ligjet që i disiplinonjë këto nisma .

- Fondacioni mund të konkurojë me projekte, apo të kërkojë fonde pranë organizatave qeveritare dhe jo qeveritare, gjithnjë në respekt te parimeve të statutit dhe të ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

- Fondacioni mund të realizojë, publikojë kërkime , analiza, studime në fushën sociale, ambientale në lidhje me qëllimin e tij .

- Fondacioni mund të promovojë, formojë dhe të ketë në brendësi të tij vullnetarë qoftë shqiptar apo të huaj të huaj.

- Fondacioni mund të promovojë instrumente, nisma dhe akte që favorizojnë rritjen e kulturës, solidaritetit, qytetarisë aktive, shpirtit social e solidar, aktivitete parandalimi dhe sensibilizimi të lidhura me qëllimin e fondacionit.

- Fondacioni mund të organizojë e të realizojë kurse formimi për edukator, animator, vullnetar, mund të realizojë kongrese, spektakle, manifestime sportive, muzikore, mund të realizojë filma-dokumentare, libra revista, gazeta, video që janë të lidhura me tematikat e ndryshme sociale, edukative e pedagogjike.

- Fondacioni mund të organizojë aktivitete sportive,letrare ,artistike ,apo ekskursione të ndryshme si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë.

### **NENI 4**

## VEPRIMTARIA

Fondacioni e ushtron aktivitetin e tij në këto Drejtime kryesore :

**-A-** Qendra multifunksionale ditore për fëmijët, adoleshentet, të rinjtë dhe të rriturit e cila ofron takime formimi , sensibilizimi dhe parandalimi për problematikat e ndryshme të trafikimit, dhunës dhe shfrytëzimit, kurse profesionale dhe formuese dhe aktivitete të ndryshme të përmendura hollësisht në nenin 3 pa përjashtuar edhe aktivitetet e ndryshme fetare.

**-B-** Shtëpia ROZALBA- Qendra Rezidenciale si Shtëpi Familjeje ku ofron shërbim rezidencial për vajzat ( në gjendje të shëndoshë fizike dhe mendore ) : jetime, viktime të dhunës, trafikimit , të braktisura nga mosha 6 -18 vjeç si dhe ofron shërbime për rastet e emergjencës për vajza, gra, nëna në vështirësi edhe këto viktime të dhunës apo trafikimit.

**-C-** Fondacioni mund të ngrejë Konvikte (ofron rezidencë për vajzat të cilat për shkaqe ekonomike ose gjeografike nuk mund të frekuentojnë shkollën e mesme, vajza nga mosha 14-18 vjeçe), si dhe ofron rezidencë për vajzat të cilat kanë mbushur moshën 18 vjeç të Shtëpisë Rozalba dhe që po përgatiten të bëhen të pavarura dhe të gatshme për të dalë në jetë.

### NENI 5

#### MOTOJA DHE MISIONI

**Motoja:** Motoja e Fondacionit “QENDRA RINORE MOTRAT VENERINI - GJADËR LEZHË” është po e njëjta moto e themelimit te Kongregatës Venerini : **Të edukosh për të çliruar.**

**Misioni:** Nëpërmjet aktiviteteve parandaluese, sensibilizuese, formuese ,dhe edukative kemi për qëllim të mbështesim dhe të shoqërojmë fëmijët, adoleshentet, të rinjtë , të rriturit dhe të gjithë personat në nevojë që të realizojnë hap pas hapi jetën e tyre dhe të kuptojnë rolin e tyre në shoqëri , duke zbuluar kështu thirrjen e tyre.

### NENI 6

#### SELIA

Fondacioni e ka **qendrën ligjore në Lezhë, fshati Gjadër.** Fondacioni zhvillon aktivitetet edhe në Lezhë, si në Shkollën Ragazionistët , por po ashtu edhe në ish SMT por mund të ushtrojë aktivitetin në të gjithë Shqipërinë . Selia mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Anëtarëve.

### NENI 7

#### KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Fondacionit “QENDRA RINORE MOTRAT VENERINI - GJADËR LEZHË” do të jetë pa afat. Kohëzgjatja mund të ndryshohet me vendim te Asamblesë së Anëtarëve

### NENI 8

#### NDALIMI I SHPËRNDARJES SE FITIMEVE

Ky fondacion është një organizatë që nuk ka qëllim ekonomik fitimprurës . Është e ndaluar që të ardhurat që përfiton fondacioni për zhvillimin e aktivitetit të tij të përdoren në favor të anëtarëve apo organeve drejtuese të tij .Të gjitha të ardhurat e fondacionit do të përdoren vetëm për realizimin dhe përmbushjen e qëllimit dhe objektivat e fondacionit . Fondacioni nuk do të ketë për qëllim të shtojë burimet e tij financiare më tepër se sa nevojitet për kryerjen e aktivitetit të tij.

Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimeve ose e përfitimit financiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e Fondacionit prej personave që janë subjekte të Statutit ose Aktit të Themelimit, përveç detyrimeve në formën e pagesave për punët e kryera në favor të Fondacionit, të pagave që rrjedhin nga kontrata e punës, shpërblimeve dhe kompensimeve nëse është rasti, gjithashtu edhe për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të Fondacionit në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së Fondacionit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **NENI 9**

### **ORGANET DREJTUESE TË FONDACIONIT**

Organet drejtuese të Fondacionit janë :

1. Mbledhja e Përgjithshme
2. Këshilli Drejtues

## **NENI 10**

### **MBLEDHJA E PËRGJITHSHME**

Mbledhja e përgjithshme është organi me i lartë vendimmarrës i Fondacionit .

-Mbledhja e përgjithshme mbledhet në séance të zakonshme të paktën një herë në vit. Ajo do të zhvillohet kur në të marrin pjesë shumica e thjeshtë e anëtarëve të shoqatës -Mbledhja e përgjithshme e jashtëzakonshme e fondacionit do të mbahet kur atë e kërkon Presidenti i Fondacionit ose të paktën 1/3 e anëtarëve të fondacionit.

Si rregull njoftimi për mbajtjen e Mbledhjes së Përgjithshme dhe çështjet që do të trajtohen në të, bëhet dy javë përpara me shkrim. Megjithatë për çështje urgjente Kryesia mund të thërrasë Mbledhjen duke aplikuar një afat me të shkurtër njoftimi.

Vendimet e mbledhjes së Përgjithshme do të jenë të vlefshme kur në mbledhje do të jenë të pranishëm të paktën ½ e anëtarëve të shoqatës dhe kur në favor të këtij vendimi kanë votuar shumica e thjeshtë e anëtarëve pjesëmarrës në atë mbledhje .

Vendimet për ndryshimin e statutit , aktit të themelimit apo programit të fondacionit, pranimin dhe përjashtimin e anëtarëve , aktet që kanë të bëjnë me buxhetin dhe shpenzimet e fondacionit , zgjedhjen ndryshimin apo shkarkimin e anëtarëve të Këshillit drejtues , shpërndarjen e fondacionit dhe caktimin e likuidatorit do të jenë të vlefshme kur në mbledhjen e përgjithshme janë të pranishëm jo më pak se 2/3 e anëtarëve të fondacionit dhe kur në favor të vendimit kanë votuar shumica absolute e të pranishmeve.

Proces verbali i Mbledhjes së Përgjithshme do të mbahet nga Sekretari i Këshillit drejtues dhe në përfundim të mbledhjes , secilit prej anëtarëve të fondacionit do t'i jepet një kopje e tij.

Mbledhja e Përgjithshme ka kompetencat që vijojnë :

-Përcakton fushat e programet e veprimtarisë së fondacionit dhe mënyrën e realizimit të këtyre programeve .

-Zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Drejtues sipas procedurave të përcaktuara më lart.

-Aprovon buxhetin vjetor të shoqatës dhe shqyrton të gjitha çështjet ekonomike , financiare dhe të administrimit të fondacionit .

-Pranon anëtarë të rinj dhe përjashton anëtarët e fondacionit .

-Ndryshon aktin e themelimit , statutin dhe programin e fondacionit .

-Nxjerr akte për rregullimin e veprimtarisë , të organizimit dhe të strukturës së organizatës.

-Vendos shpërndarjen e fondacionit dhe cakton likuidatorin për zhvillimin e procedurës së likuidimit të fondacionit .

-Merr vendime për hapjen e degëve të reja të fondacionit .

-Krijon komisione ose organizma në varësi të veprimtarisë së fondacionit .

-Ushtron çdo kompetence tjetër që asaj i njihet nga ligji.

Mbledhja e përgjithshme mund të votojë dhe marrë vendime vetëm për çështjet e përcaktuara në rendin e ditës.

## **NENI 11 KËSHILLI DREJTUES**

Këshilli drejtues është organi me i lartë ekzekutiv i fondacionit . Ai përbehet nga Presidenti, zv/presidenti , sekretari dhe një anëtar . Në varësi të ndryshimit të numrit të anëtarëve të fondacionit , Mbledhja e Përgjithshme mund të zgjedh anëtarë të rinj të Këshillit Drejtues .

-Këshilli Drejtues merret me veprimtarinë e përditshme të fondacionit dhe kryen detyra të tjera të veçanta sipas vendimeve të Mbledhjes së Përgjithshme .

Këshilli drejtues i rekomandon Mbledhjes së Përgjithshme iniciativa të ndryshme dhe masa në favor të anëtarëve të fondacionit dhe për realizimin e qëllimit dhe objektivave të fondacionit . Ai drejton veprimtarinë e fondacionit për periudhën mes dy mbledhjeve , në përputhje me statutin dhe vendimet e mbledhjes së përgjithshme .

-Këshilli Drejtues shqyrton paraprakisht dokumentacionin për pranimin e anëtarëve të rinj të fondacionit dhe ia paraqet atë për miratim Mbledhjes së përgjithshme të radhës.

-Këshilli drejtues harton programin e aktiviteteve të fondacionit dhe ia paraqet atë për miratim Mbledhjes së përgjithshme , cakton delegacionet për aktivitetet të ndryshme brenda dhe jashtë vendit , koordinon veprimet me organizatat e tjera homologe , si dhe kryen çdo veprimtari të njohur atij me ligj.

-Këshilli Drejtues emëron punonjësen e financës së fondacionit .

-Këshilli Drejtues mblidhet jo më pak se një herë në gjashtë muaj, ose kur kërkohet nga të paktën 1/3 e anëtarëve të tij. Mbledhjet e Këshillit Drejtues zhvillohen kur në të marrin pjesë jo më pak se 2/3 e anëtarëve .Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash . Në rast numri votash të barabarta , vota e kryetarit do të jetë vendimtare.

Anëtarët e Këshillit drejtues nuk do të përfitojnë asnjë lloj shpërblimi për punën e kryer prej tyre.

-Këshilli drejtues do të kujdeset për mbajtjen në minimum të shpenzimeve të fondacionit. Të gjitha veprimet bankare në emër e për llogari të fondacionit , si dhe veprimet kundrejt të tretëve do realizohen nga Kryetari i Këshillit Drejtues dhe në mungesë të tij nga nënkryetari ,ose çdo person i autorizuar me prokurë nga ata.

## **NENI 12 FINANCIMI**

-Aktiviteti i Fondacionit “QENDRA RINORE MOTRAT VENERINI - GJADËR LEZHË” do të financohet nga kuotat e anëtarësisë së anëtareve dhe nga interesat që përfitohen prej depozitimit të fondeve në llogarinë bankare të shoqatës. Gjithashtu , fondacioni do të financohet nga grantet, donacionet e ndryshme të personave fizike dhe juridike , vendas a te huaj. Të gjitha të ardhurat që fondacioni do të realizojë nga veprimtaria e saj ekonomike financiare do të përdoren për realizimin e qëllimit dhe të objektivave të saj. Është e ndaluar ndarja e të ardhurave të fondacionit anëtarëve të saj.

-Kuota mujore e anëtarësisë në Fondacion do të jete 100(njëqind ) lekë dhe do të paguhet në fillim të çdo muaji pranë Këshillit Drejtues .

Sekretari i Këshillit Drejtues do të mbajë të dhëna të sakta në lidhje me pagimin e kuotave mujore .Kuota mujore mund të ndryshohet në varësi të veprimtarisë së shoqatës , me miratimin e Mbledhjes së Përgjithshme.

-Në Mbledhjen e parë të çdo viti (Mbledhja vjetore ) , Mbledhjes së përgjithshme do t'i paraqitet pasqyra financiare e shoqatës për vitin paraardhës si dhe do te miratohet buxheti i shoqatës për vitin në vazhdim.

## **NENI 13 ANËTARËSIA**

-Anëtar i Fondacionit “QENDRA RINORE MOTRAT VENERINI - GJADËR LEZHË” mund të jenë të gjithë individët pa dallim race apo ngjyre si dhe prejardhje shoqërore të cilët janë të interesuar për realizimin e qëllimit të fondacionit .

-Anëtarësia në Fondacion është vullnetare . Çdo person që do të bëhet anëtar i fondacionit duhet të paraqesë përpara Këshillit Drejtues të fondacionit një kërkesë për anëtarësimin në Shoqatë dhe një fotokopje të kartës së identitetit . Pranimi i tij në fondacion bëhet nga Mbledhja e Përgjithshme , sipas procedurave të përcaktuara më lart. Pas pranimit të tij si anëtar , emri i anëtarit të ri do të regjistrohet në librin e fondacionit .

-Çdo anëtar mund të heqë dorë nga anëtarësia duke njoftuar me shkrim Këshillin Drejtues dy javë përpara ditës së fundit të çdo muaji.

-Anëtarët përjashtohen nga fondacionit me vendim të Mbledhjes së Përgjithshme kur:

-Kryejnë veprime që dëmtojnë fondacionin ose qëllimet e tij.

-Nuk paguajnë kuotat e anëtarësisë

-Nuk përmbushin kushtet e anëtarësisë.

## **NENI 14 DEGËT**

Fondacioni zhvillon aktivitetin e saj pa kufizim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Ajo mund të themelojë dege të saj në qendër ose ne çdo njësi tjetër administrativo territoriale të Shqipërisë, njëkohësisht mund të themelojë dege ose filiale edhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**NENI 15**  
**SHPËRNDARJA E FONDACIONIT**

Fondacioni e ndërpret veprimtarinë e saj kur numri i anëtarëve zbret nën numrin e anëtarëve themelues, kur Fondacioni e ka përmbushur qëllimin dhe objektivat e saj si dhe në të gjitha rastet e tjera kur parashikohet me ligj. Vendimi për shpërndarjen e Fondacionit merret nga Mbledhja e Përgjithshme , sipas procedurave të përcaktuara më lart. Ne këtë mbledhje caktohet edhe likuidatori i Fondacionit.

**NENI 16**  
**Dispozita të fundit**

Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe Ligji Nr. 8788, dt. 07.05.2001, “Për Organizatat jofitimprurëse” (i ndryshuar).

Ky statut hartohet në gjuhën shqipe, në 3 kopje me vlerë të njëjtë.

**ANËTARËT THEMELUES**

Anëtarët themelues të Fondacionit “QENDRA RINORE MOTRAT VENERINI - GJADËR LEZHË”

President – enricheta giovannini  
Zv/ president – Arta Suli  
Anëtare ( sekretare ) Alma Zogu